



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 40 datë 25.9.2020**

**“PËR MIRATIMIN PËR DHËNIE ME QIRA/ENFITEOZË TË PRONËS  
“THERTORE TEK URA E BUNËS, ME NR. PASURIE ME NR. 19/ 63, ME NR.  
19/156 DHE ME NR. 19/230N, E NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8591-R-3,  
ME NR. RENDOR 107 NË LISTEN E INVENTARIT TË PRONAVE ME  
SIPËRFAQE TOTALE TË PRONËS 1112 (NJË MIJË E NJËQIND E  
DYMBËDHJETË)M2 NGA TË CILAT 796 (SHTATËQIND E NËNTËDHJETË E  
GJASHTË )M2 NDËRTESE”**

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e tij te datës 25.9.2020, me propozim të Kryetares të Bashkisë mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e/1” të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 8743, dt. 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar; VKM nr.500 datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njesitë e QeverisjesVendore” i ndryshuar; VKM nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër” të ndryshuar; VKB nr.9, datë 26.02.2020 “Për saktësimin e të dhënave dhe ndryshimin e fushës së përdorimit, të pjesshëm, të VKB nr 51, datë 14.06.2009 për “Miratimin e listës së pjesshme te pronave të paluajshme shteterore që kërkohen për transferim në pronësi të bashkisë Shkodër” ;VKM nr 54 date 05.02.2014 "Për percaktimin e kriterëve, të procedurës e te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik” pas shqyrtimit të Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër, me 34 vota Pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për dhënie me qira/enfiteozë të pronës: “Thertore tek Ura e Bunës, me nr. pasurie me nr 19/ 63, me nr. 19/156, dhe me nr 19/230N, e ndodhur në zonën kadastrale 8591-R-3, me nr rendor 107 në listen e inventarit të pronave, me

sipërfaqe totale të pronës 1112 (një mijë e njëqind e dymbëdhjetë)m2 nga të cilat 796 (shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë )m2 ndërtesë.

2. Afati i dhënies me qira/enfiteozë sipas procedurës të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.54/2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të menyres së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" të ndryshuar, do të jetë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet dhe jo më shumë se 30 vjet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**



Denis Lesha

**KRYETARE**

